# DËSHMI ARKIVI

**A-440103**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozita numëron kushërinjtë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/emerimi-i-yllka-kukalajt-ne-oshish-spahiu-i-pergjigjet-kritikave-menaxh-i585856` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 16:41:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 16:36:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7a7428ae2c1d6bfa3e6d5d97c60af5b60b5bd3c0b6fb8c4c336916184fd9be23` |
| TEKSTI | `d878e017ba316f537ce9d1f47b09ef3022dcb55bc5d0e4a8cfef324e03d88ee5` |
| PAMJA | `fbff9fae442c9d0000036768369ec2a65b8baf918dddb9c836a7be0b9a534fad` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9a213f4d99eb80bbc9771b0c6eb12373348ba3bed91e1571a688153aa880b81b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a605a4f1977ffafcd955a727087f4d8630a9c3b096f49d9eff2d57be1cc228b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9a213f4d99eb80bbc9771b0c6eb12373348ba3bed91e1571a688153aa880b81b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozita numëron kushërinjtë

TemA

13 Shtator 2026, 18:36Politika TEMA




Ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, ka reaguar pas pyetjeve të ngritura nga Bardh Spahia për emërimin e Yllka Kukalajt në drejtim të OSHISH.

Spahiu mbrojti zgjedhjen duke renditur eksperiencën e Kukalajt në administrimin e financave dhe drejtimin e spitalit të Krujës, ndërsa hodhi poshtë kritikat që e lidhin emërimin me marrëdhënie familjare. Sipas saj, drejtuesit do të gjykohen për punën dhe jo për "pemën gjenealogjike".

**Reagimi i plotë i Ministres së Shëndetësisë:**

*Z. Bardh Spahia ka pyetur publikisht për emërimin e Yllka Kukalajt. Ka të drejtë të pyesë. Unë kam detyrë të përgjigjem.*
*Pse Yllka Kukalaj?*
*Sepse në atë detyrë nuk më duhet dikush që ta mësojë punën. Më duhet dikush që e njeh atë.*
*Yllka Kukalaj është ekonomiste. Ka drejtuar sektorin e buxhetit dhe pagave në bashkinë e Krujës, pastaj spitalin e qytetit, për vite, si titullare e autoritetit kontraktor.*
*Në atë spital ishte kur ra tërmeti, kur erdhi pandemia, kur u rindërtua godina dhe aty e kam njohur në punë.*
*Kush e ka kaluar këtë rrugë të shërbimit e di sa kushton një shtrat dhe sa kushton një pajisje.*
*Atyre që thonë se Yllka Kukalaj qenka "anonime" i them po, me siguri është anonime për kafenetë politike të Tiranës. Nuk është anonime për spitalin që ka drejtuar, për mijëra pacientët që janë shërbyer dhe për peshën e madhe të përgjegjësisë që ka mbajtur përsipër.*
*Për kushërirat: ka një mënyrë shumë të vjetër për t'i goditur gratë që marrin një detyrë publike.*
*Zhduket karriera profesionale dhe fillon gjurmimi në pemën gjenealogjike.*
*Burrave u numërohen heroizmat. Grave u numërohen kushërinjtë.*
*Kjo nuk është mënyra ime.*
*Yllka Kukalaj do të gjykohet për atë që bën në OSHISH, si çdo drejtues tjetër që do të emëroj.*
*Me mua profesionisti vjen përpara paragjykimit dhe qytetari vjen përpara koncesionit.*
*Prandaj Yllka Kukalaj në drejtim dhe prandaj edhe rishikimi i imët i një procedure të gjetur të hapur mbrapsht.*
*Këtë metodë di. Për këtë metodë kam ardhur. Nga kjo metodë nuk heq dorë!*

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Fisi pret kthimin e kryetarit” - Demaliaj ironizon pritjen e Berishës në Rinas: Shkoi te dentisti amerikan për të ndërruar protezat para vdekjes]

18:00 Politika / 1 koment

Reforma territoriale, Rama nga Berati: Poliçani dhe Dimali do të marrin të njëjtat shërbime, por brenda bashkisë Berat

17:50 Politika

Protesta/ Ambulanca vonohet mes turmës! Protestuesit refuzuan t'i hapnin rrugën (VIDEO)

16:35 Politika / 6 komente



[Rama: Shqipëria ndryshon nga vendet e tjera në tranzicion sepse ka patur ëndrrën e BE-së]

14:50 Politika / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.